



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2019:283938

Datë: 25.02.2025

Numri i dokumentit: 06896154

P.nr.690/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA NË LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Selman Salihu, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Vesa Bajrami, në çështjen penale kundër të pandehurve S. A. nga L. dhe B. A. nga fsh.R. I V. K.L., të cilët i akuzon Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën PP.I.nr.134/2019 të datës 14.11.2019, të pandehurin S. A. për shkak të veprës penale Lëndim i rendë trupor nga neni 186 par.3 pika 3.1 lidhur me par.1 pika 1.2 të KPRK-së dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së ndërsa të pandehurin B. A. për shkak të veprës penale Pjesëmarrja në rrahje nga neni 187 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik me datë 27.01.2025, në prani të prokurores së shtetit Nebahate Salihu, të pandehurit S. A. dhe mbrojtësit të tij av.Fitim Gashi, të pandehurit B. A. dhe, mbrojtësit të të pandehurit av. Jusuf Bytyqi, me datë 04.02.2025, publikisht shpalli, dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurve:

I.S. A., i lindur me ... në L., ku edhe jeton në rrugën "... " p/n, nga i ati H., me numër personal ..., Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ishte në PARABURGIM prej datës 22.07.2019 deri më 22.10.2019.

II.B. AH., i lindur me ... në P., me vendbanim në fshatin R. i V., Komuna e L., nga i ati Z. dhe e ëma M., mbiemri i vajzërisë së nënës B. me numër personal ..., i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ishte në PARABURGIM prej datës 22.07.2019 deri më 22.08.2019.

J A N Ë F A J T O R

Sepse:

I pandehuri i parë S. A.:

I.Me datë 22.07.2019 rreth orës 21:40 në L. në rrugën „,...“ gjatë rrahjës e cila ka ndodhur në mes tani të pandehurve për shkak të problemeve që kanë pasur në mes tyre e në të cilën nga njera anë kanë marrë pjesë të pandehurit B. A. dhe S. A. edhe me disa N.N. Persona, e nga ana tjetër të pandehurit B. K. dhe M. R. edhe me disa N.N.Persona në një moment i pandehuri i parë

S. A. nga çanta ka nxjerrë armën e zjarrit-pistoletën ngjyrë të zeze me mbishkrim „Made in Croatia" dhe ka shkrepur fillimisht dy fishek në ajër e pas kësaj tri herë ka shkrepur në drejtim të të pandehurve B. K. dhe M. R. si dhe personit R. K. dhe personave tjerë N.N, me çrast ka goditur B. K. në regjionin e shputës së majtë, duke i shkaktuar thyrje të kockës së shputës si dhe ndrydhje të indeve të buta të kokës, shpatullës dhe shpindës, kurse M. R. e ka goditur në nënharkun brinjor të djathtë dhe në dorën e djathtë e cila ka rezultuar me këputje të pjesëshme të tetivës së muskulit që terheqë gishtin e II (dytë), të cilat lëndime në bazë të Raportit të ekspertit mjeko-ligjor Bergita Curri i dt.09.08.2019 janë kualifikuar si Lëndime të Rënda Trupore të shkaktuar me veprim të armës së zjarrit,

-me këtë ka kryer veprën penale Lëndim i Rëndë Trupor nga neni 186 par 3. pika 3.1 lidhur me par 1.pika 1.2 Të KPRK-së. .

II. Me datë, në kohën dhe në vendin nga parag I. i dispozitivit të kësaj Aktakuze ka përdorë armën e zjarrit-pistoletën e kalibrit 9 mm, me mbishkrim „Made In Croatia" me numër serik H199503 nga e cila në vendin e ngjarjes ka shkrepur 5 fishek aq sa janë gjetur edhe gëzhoja në kundërshtim me lejën e lëshuar me datë 13.02.2015 me afat të skadimit me 12.02.2020 e cila të pandehurit i është lëshuar vetëm për shenjëtari të cilën së bashku me një karikator dhe 14 fishek ia ka dorzuar Policisë gjatë arrestimit,

-me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në Pronësi, Kontroll ose Posedim të Paautorizuar të Armëve nga neni 366 par 1. Të KPRK-së.

I pandehuri i dytë B. A.:

III. Me datën, në kohën dhe në vendin nga paragrafi I. i dispozitivit të kësaj Aktakuze, ka marrë pjesë në rrahje e cila ka ndodhur në mes tani të pandehurve me çrast me qëllim që ti frikësoj dhe kanos të pandehurit B. K. edhe M. R. të njejtit i ka sulmuar fizikisht me shkop metalik në duar, mjet të përshtatim që të ju shkaktoj lëndime të rënda trupore ose që seriozisht të ju dëmtoj shëndetin,

-me këtë ka kryer veprën penale Pjesëmarrja në Rrahje nga neni 187 par 2.lidhur me par 1. Të KPRK-së.

IV.Me datë, në kohë dhe në vendin nga par I. i dispozitivit të kësaj Aktakuze ka përdorë armën e ftohtë-shkopin metalik ngjyrë të zezë me mbishkrim në dorëz „Pardened Police Baton"që është gjetur në vendin e ngjarjes në afërsi të automjetit të markës „Golf ngjyrë e zezë me targa të regjistrimit EX 404YR,

-me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në Pronësi, Kontroll ose Posedim të Paautorizuar të Armëve nga neni 366 par 1. Të KPRK-së.

Andaj gjykata konform neneve 1, 2, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 44, 69, 71 të KPRK-së, nenit 186 par 3. pika 3.1 lidhur me par 1.pika 1.2, nenit 366 par 1., nenit 187 par 2.lidhur me par 1. të KPRK-së dhe nenit 364 të KPRK-së, të pandehurit i:

G J Y K O N

Të pandehurin e pare S. A. **për veprën e pare penale Me denim me burg** në kohëzgjatje prej 6 muajve, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit dhe konform nenit 44 të KPRK-së i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 1600-€ (njëmijëetëqindeuro), të cilin dënim i pandehuri detyrohet ta paguaj në afat prej 15 dite, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, në të kundërtën dënimi me gjobë, konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, do të zëvendësohet me dënim me burgim, ku për një ditë burgu do ti llogaritet shuma prej 20-€, dhe **për veprën e dytë penale Me denim me gjobë** në shumën prej 200-€ (dyqindeuro) i cili dënim do të ekzekutohet pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast se dënimi nuk realizohet as me detyrim, gjykata dënimin me gjobë do ta zëvendësojë konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burg, të llogaritet shuma prej 20-€,

Të pandehurin e dytë B. A. **për veprën e pare penale Me denim me gjobë** në shumën prej 400-€ (katërqindeuro) i cili dënim do të ekzekutohet pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast se dënimi nuk realizohet as me detyrim, gjykata dënimin me gjobë do ta zëvendësojë konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burg, të llogaritet shuma prej 20-€, dhe **për veprën e dytë penale Me denim me gjobë** në shumën prej 200-€ (dyqindeuro) i cili dënim do të ekzekutohet pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast se dënimi nuk realizohet as me detyrim, gjykata dënimin me gjobë do ta zëvendësojë konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burg, të llogaritet shuma prej 20-€,

Konform nenit 76 par.2 nënpar 2.7 të KPRK-së, gjykata iu shqipton:

DËNIM UNIK ME GJOBË

I. Të pandehurin e pare S. A. në shumë prej 1800-€ (njëmijëetëqindeuro), tcilin denim i pandehuri detyrohet ta paguaj në afat prej 15 dite, nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit. Me pëlqimin e te pandehurit dhe conform nenit 44 te KPRK-se, te njtit I zevdsohet nga denimi me burg ne ate me gjebe ne shume të kundërtën dënimi me gjobë, konform nenit 43 par.3 të KPRK-së do të zëvendësohet me dënim me burgim, për një ditë burgu do ti llogaritet shuma prej 20.-€, në të cilin denim do të i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 22.07.2019 deri me dt.22.10.2019.

II. Të pandehurin e dytë B. A. në shumë prej 600-€ (gjashtëqindeuro), të cilin denim i pandehuri detyrohet ta paguaj në afat prej 15 dite, nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën dënimi me gjobë, konform nenit 43 par.3 të KPRK-së do të zëvendësohet me dënim me burgim, për një ditë burgu do ti llogaritet shuma prej 20.-€, në të cilin denim do të i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 22.07.2019 deri me dt. 22.08.2019.

OBLIGOHEN të pandehurit që kësaj gjykate, që secili veç e veç në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të ia paguajnë shumën prej 30-€ dhe shumën prej 20-€, në Fondin e Viktimave të krimit, këto në afat prej 15 dite pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Të dëmtuarit: B. K. dhe M. R. udhëzohen që kërkesën pasurore juridike ta realizojnë në kontest të rregullt civil.

KONFISKOHET arma e zjarrit-pistoleta e kalibrit 9mm, me mbishkrimin “Made in Croatia” me nr. serik H199503 e gjetur tek i pandehuri i pare S. A. dhe sendi-shkopi metalik

ngjyrë të zezë me mbishkrim në dorezë Pardeded Police Baton”, e gjetur tek i pandehuri i dytë B. A..

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.I.nr.134/2019 të datës 14.11.2019, e ka akuzuar të pandehurin të pandehurin S. A. për shkak të veprës penale Lëndim i rendë trupor nga neni 186 par.3 pika 3.1 lidhur me par.1 pika 1.2 të KPRK-së dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, të pandehurin B. A. për shkak të veprës penale Pjesëmarrja në rrahje nga neni 187 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, të pandehurin B. K. për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 pika 1.4 të KPRK-së dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, të pandehurin M. R. për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 pika 1.4 të KPRK-së dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Ndaj të pandehurve M. R. dhe B. K. është veqar procedura, ndërsa shqyrtimi gjyqësor ka përfunduar vetëm ndaj të pandehurve S. A. dhe B. A..

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor publik më dt. 27.01.2024, gjatë së cilës u dëgjuan Prokurori i shtetit, të pandehurit dhe mbrojtësit e të pandehurve.

Në shqyrtimin gjyqësor i pandehuri S. A. ka deklaruar se ndien veten fajtor dhe e pranon fajsinë me vullnetin e tij, pa presion, nuk e ka kundërshtuar aktakuzën, i bindur për pasojat e pranimin të fajësise dhe pranimin e fajësise e ka bërë me konsultim me mbrojtësin e tij. Është shprehur i penduar që ka ndodhur kjo, I vjen keq, ka shtuar se janë pajtuar me të dëmtuarit.

Ndërsa në fjalën përfundimtare I pandehuri S. A. ka qendruar pranë deklaratës së lartëshënuar dhe pranë fjalës përfundimtare të mbrojtësit të tij.

Në shqyrtimin gjyqësor i pandehuri B. A. ka deklaruar se e ndien veten fajtor dhe e pranon fajësinë me vullnetin e tij, ka shtuar se kanë qenë në pozitë të rendë dhe kemi qenë të sulmuar si dhe ky nuk i iki pergjegjesis për aq sa unë edhe kam qenë fajtor. Ka shprehur se i vjen keq që ka ndodhur, është i penduar dhe i ka premtuar gjykatës se nuk do ta përserisë më.

Ndërsa në fjalën përfundimtare i pandehuri B. A. ka qendruar pranë fjalës përfundimtare të mbrojtësit të tij.

Mbrojtësi I të pandehurit të pare av.F. G. në seancën për shqyrtim gjyqësor ka deklar se meqë i mbrojturi I tij e ka pranuar fajsinë duke qenë i njoftuar për pasojat dhe benefitet që sjell ky pranim atëherë gjykatës i ka propozuar të aprovohet një pranim i fajësise dhe gjykatës i ka propozuar që me rastin e matjes së dënimit të merr parasysh si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë poashtu të merr parasysh faktin se familja A. dhe Familja K. si dhe R. janë pajtuar mes vete për këtë ka prova në shkresat e lëndes dhe se nuk kanë telashe në mes vete, gjithashtu ka kërkuar nga gjykata që si rrethana lehtësuese të merr dhe sjelljet e mbrojturit të tij gjatë procesit gjyqësor dhe karakteristikat personale, dhe faktin se është mbajtes i familjes dhe është hera e pare që i njejtë ka rënë ndesh me ligjin. Mbi bazën e gjitha këtyre gjykatës I ka propozuar që të I shqiptoj një dënim sa me të butë dhe të pranushem për të mbrojturin e tij.

Ndërsa në fjalën përfundimtare mbrojtësi i të pandehurit të pare av.Fitim Gashi ka qendruar pranë deklaratës së lartëshënuar.

Mbrojtësi i të pandehurit të dytë av.Jusuf Bytyqi në seancën për shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se bazuar ne rrethanat siç pretendohet se është kryer vepra penale duke përfshirë edhe rrethanat në të cilat është implikuar edhe i mbrojturi I tij e që janë sqaruar ne provat e shkresave të kesaj lende, pranimi i fajësise është nje veprim i mire i te mbrojturit të tij dhe konsiderojnë se gjykata duhet të ketë parasysh dhe madje të merr si nje rrethanë te veqant lehtesuse me rastin e matjes se denimit. Po ashtu edhe rrethanat tjera lehtesuse se i mbrojturi i tij ka pasur sjellje korrekte si dhe koshiente ne kete qështje penale fakti se asnjëherë më parë nuk ka rënë ndesh me ligjin janë rrethana lehtësuese, gjykates i ka propozuar që ti ketë parasysh me rastin e matjes se denimit keshtu qe ti i shqiptoi nje denim te arsyshem me te cilin konsiderojm se arrihet qellimi i sanksionit.

Ndërsa në fjalën përfundimtare mbrojtësi i të pandehurit të pare av.Jusuf Bytyqi ka qendruar pranë deklaratës së lartëshënuar.

Prokuroria e shtetit në seancën për shqyrtim fillestar ka deklaruar nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve pasi që janë plotësuar kushtet nga neni 242 të KPPRK-së.

Gjyqtari i vetëm gjykues, i bindur se të pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme dhe pas konsultimeve me mbrojtësit, pranimi i fajit mbështet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore, konform nenit 241 të KPPRK-së, gjykata e pranoi pranimin e fajësisë, për veprat penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata duke analizuar provat mbi faktet siç janë: kallëzimi penal me nr. të rastit 2019-AH-631 I dt.23.07.2019, raporti fillestar I incidentit i dt.23.07.2019, deklarata e të dyshuarit M. R. e dhënë në polici me dt.23.07.2019, deklarata e të pandehurit B. K. e dt.23.07.2019, deklarata e të pandehurit S. A. e dt.23.07.2019, deklarata e të pandehurit B. A. e dt.23.07.2023, raporti I oficerit policer S. K. i dt.23.07.2019, raporti i policies i dt.23.07.2019, raporti shtesë i policies I dt.23.07.2019, raportet mjekësore, të dhënat e kaluara nga evidence penale e të pandehurve si dhe shkresave tjera të lëndës konstaton se ka prova të mjaftueshme në drejtim të vërtetimit të fakteve se të pandehurit vërtetë kanë kryer veprat penale për të cilat akuzohen, si dhe marrë parasysh deklaratat e të pandehurve dhe provat e bashkangjitura të cilat përputhen me njëra tjetrën u vërtetua se të pandehurit I kanë kryer veprat penale me të cilat ngarkohen.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin S. A. gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara me nenin 69 të KPRK-së, ashtu që si rrethana lehtësuese gjykata për të pandehurin e vlerësoi pendimin për veprimet e tij, faktin se i njejt ka premtuar se nuk do ta përsërisë veprime të tilla, faktin se i njejt është i moshës së re, rrethanat familjare pra faktin se i njejt është i martuar, ka dy fëmijë dhe është mbajtës i familjes, faktin se familjarët e të pandehurve si dhe të pandehurit janë pajtuar dhe i kanë falur të pandehurit e vërtetuar me marrëveshjen mbi pajtimin dhe zgjidhjen e kontestit në mënyrë paqësore e lidhur te noteri Z. A. me seli në L. me nr. identifikues LRP.nr.7369/2019 dhe Ref.nr.1333/2019, faktin se të pandehurit S. A. dhe B. A. kanë qenë të sulmuar fillimisht nga të pandehurit e tjerë ndaj të cilëve është veqar dhe si rrjedhojë janë inkriminuar edhe veprimet e të pandehurit S. A., procedura e veçanërisht pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethana rënduese gjykata pati për bazë intesitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, peshën e veprës

penale dhe të njëjtit i shqiptoi dënimin e paraparë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit në pajtim me nenin 38 të KPRK-së. Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e aktgjykimit, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e kryesit, si dhe do të ndikoj tek të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 38 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin B. A. gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara me nenin 69 të KPRK-së, ashtu që si rrethana lehtësuese gjykata për të pandehurin e vlerësoi pendimin për veprimet e tij, faktin se i njëjti ka premtuar se nuk do ta përsërisë veprime të tilla, faktin se i njëjti është i moshës së re, rrethanat familjare pra faktin se i njëjti është i martuar, ka katër fëmijë dhe është mbajtës i familjes, faktin se familjarët e të pandehurve si dhe të pandehurit janë pajtuar dhe i kanë falur të pandehurit e vërtetuar me marrëveshjen mbi pajtimin dhe zgjidhjen e kontestit në mënyrë paqësore e lidhur te noteri Z. A. me seli në L. me nr. identifikues LRP.nr.7369/2019 dhe Ref.nr.1333/2019, faktin se të pandehurit S. A. dhe B. A. kanë qenë të sulmuar fillimisht nga të pandehurit e tjerë ndaj të cilëve është veqar dhe si rrjedhojë janë inkrimuar edhe veprimet e të pandehurit B. A. e veçanërisht pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethana rënduese gjykata pati për bazë intesitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, peshën e veprës penale dhe të njëjtit i shqiptoi dënimin e paraparë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit në pajtim me nenin 38 të KPRK-së. Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e aktgjykimit, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e kryesit, si dhe do të ndikoj tek të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 38 të KPRK-së.

Meqenëse të pandehurit e kanë pranuar fajësinë gjykata bëri zbutjen e dënimit të të pandehurve conform dispozitës së nenit 71 par.1.3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale bazohet në nenin 450 të KPPRK-së, në nenin vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u mor në bazë të nenit 36 par. 3 pika 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, vendimi mbi kërkesën pasurore juridike u bazua në nenin 462 të KPPRK-së.

Vendimi për konfiskim u bazua në nenin 366 par.3 të KPPRK-së.

Vendimi për llogaritjen e paraburgimit në dënimin e shqiptuar u bazua në nenin 79 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË LIPJAN

P.nr.690/19 te dt. 04.02.2025

**Bashkëpunëtorja profesionale,
Vesa Bajrami**

**GJYQTARI
Selman Salih**

Numri i lëndës: 2019:283938
Datë: 25.02.2025
Numri i dokumentit: 06896154

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit. Ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.